



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:268824

Datë: 26.05.2021

Numri i dokumentit: 01817790

A.nr.1005/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me sekretaren juridike Sanie Salihu, në konfliktin administrativ, të paditësit D. F. nga fshati P. komuna e Prishtinës, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.231/14 datë 12.04.2018, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti – kundërvajtje doganore, vlerë kontesti e pa përcakëtuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të mbajtur me datë 17.05.2021, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit D. F. nga fshati P. komuna e Prishtinës, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi 05/2a/Nr.502 i datës 24.08.2006 i Doganës së Kosovës në Prishtinë
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Lënda në këtë konflikt administrativ është kthyer në rivendosje-rigjykim sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.231/14 datë 12.04.2018, dhe është anuluar vendimi i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime A.636/2006 –SHD i datës 14.04.2014, ndërsa tani në rivendosje-rigjykim vlerësohet ligjshmëria e vendimit të organit të shkallës së parë, respektivisht vendimi i Departamentit të Ankesave i Doganës së Kosovës nr.05/2a/502 i datës 24.08.2006 si vendim kontestues në mes palëve në këtë çështje të konfliktit administrativ, dhe ankesa e datës 24.10.2006 e parashtruar në atë

kohë pranë BPR-së, tani në këtë lëndë të konfliktit administrativ konsiderohet ankesë-padi.

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 24.10.2006, ka iniciuar konfliktin administrativ ndaj Aktvendimit nr.05/2A-502 i datës 24.08.2006, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për shkak të lajthitjes nga ana e pronarit të firmës “J.” nga Graçanica, pasi që sipas paditësit i njëjti nuk ka qenë në dijeni se është duke bartur mall në kundërshtim me rregullativën doganore dhe të akcizës dhe si pasojë e kësaj i është konfiskuar automjeti i vetmi burim financiar i familjes 7 anëtarëshe. Andaj kërkon që të aprovohet ankesa dhe të konstatohet se paditësi është sjell në lajthitje nga ana e pronarit të firmës “J.” duke i futur në furgon një sasi të mallit jashtë fature, andaj duke marr për bazë edhe gjendjen e vështirë materiale të paditësit, kërkon që t’i kthehet furgoni i tipit Ford trans me targë ..., ndërsa pjesa tjetër e mallit të mbetet e konfiskuar deri në marrjen e aktvendimit të formës së prerë.

Në përgjigjen në padi të datës 23.11.2006 e paditura deklaron se duke vlerësuar gjendjen faktike e cila del nga shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore të palës, e paditura gjen se ankesa është e pabazë dhe vjen në përfundim se në mënyrë të drejtë janë aplikuar dispozitat përkatëse ligjore ku është vlerësuar se është shkaktuar kundërvajtje dhe bazuar në këtë rezulton edhe përgjegjësia kundërvajtëse e paditësit. Nga rrethanat e rastit është konstatuar se paditësi është kontrolluar nga ana e njesitit Fast 13 dhe i njëjti ka qenë duke vozitur automjetin e tij, me ç’rast në automjet është gjetur një sasi e mallit për të cilën nuk janë paguar detyrimet doganore. Në këtë rast është konstatuar se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e kodit të Akcizës neni 26 paragrafi 1 pika c ku parashihet që “ *nëse një person ofron për shitje, shet, eksporton, transporton apo është në posedim ose mërret me produkt të akcizës, i cili është i ngarkuar me detyrime të akcizës e që nuk është paguar, ose në ndonjë mënyrë i është ndërlidhur me shmangie nga pagesa e akcizës, për produkte me akcizë, do të pasoj gjiba administrative në shumë prej 500.00 deri 10,000.00€ si dhe produktet e ngarkuara me akcizë do t’i nënshtrohen ndaljes ose konfiskimit*”. Në rastin konkret paditësi është gjetur duke bartur produkte për të cilat nuk është kryer obligimi mbi pagesën e taksës së akcizës dhe si i tillë i është nënshtuar gjobës administrative, lartësia e së cilës është në përputhje me dispozitat ligjore që përcaktojnë vlerën e gjobës administrative, ndërsa për produktet me akcizë është shqiptuar masa e konfiskimit.

Meqënëse pala në procedurë përms ankesës kërkon vetëm kthimin e automjetit i cili është konfiskuar, pas shqyrtimit të lëndës është konstatuar se sikur sektori antikontrabandë ashtu edhe sektori për rishqyrtime gjatë rishqyrtimit të vendimit sipas kërkesës së palës ka vepruar drejtë kur ka vendosur që për automjetin të mbetet në fuqi masa e konfiskimit në vështrim të nenit 29 paragrafi 1 pika a, të kodit mbi Akcizën. Në fund i propozon gjykatës që që ankesa e palës të refuzohet pasi që pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së për arsye se paditësit edhe pse i është komunikuar ftesa përmes tabelës së shpalljeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i njëjti nuk ka qënë prezent në seancë (*provë fletëkthesa e datës 21.04.2021*). Ndërsa pala e paditur përmes parashtresës së datës 11.05.2021 e ka njoftuar Gjykatën se nuk mund të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që të veprohet konform nenit 38 paragrafi 5 dhe nenin 41 të LKA-së (*provë: Parashtrësja e datës 11.05.2021 nga Dogana e Kosovës*).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 17.05.2021, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi nr.636/06 i datës 14.04.2014, aktvendimi nr.05/2A/502 i datës 24.08.2006, Aktgjykimi AA.nr.231/14 i datës 12.04.2018, Parashtrësja e BPR-së e datës 02.10.2014, Aktgjykimi A.nr.117/07 i datës 28.04.2010, Ankesa e ushtruar në Doganën e Kosovës e datës 03.07.2006, Aktvendimi nr.149/06 i datës 28.06.2006, Raporti nr.03/03.05.2006, Shenim referim i rastit i datës 04.05.2006, raporti i policisë i datës 03.05.2006, Proces komisioni i datës 17.06.2006, librezja e veturës, fatura nr.10-05/03.05.2006, Shenim i doganës nr.251361/05.04.2006, deklarata e datës 03.05.2006, aneksi i datës 03.05.2006, Vërtetimi 02/2006 i datës 03.05.2006, Shënim i Prokurorisë publike komunale në Mitrovicë i datës 08.06.2006, përgjigja në Ankesë e datës 23.11.2006.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi dhe seancë, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur

edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata ka gjetur se e paditura Dogana e Kosovës e ka refuzuar kërkesën e këtu paditësit të ushtruar ndaj aktvendimit nr.149/06 të datës 28.06.2006, të lëshuar nga Sektori Antikontrabandë. E paditura ka vlerësuar se kërkesa e subjektit në procedurë është e pabazë për arsye se me datë 03.05.2006 në fsh.Zh. komuna e Mitrovicës, Policia e Kosovës ka ndalur ndalur automjetin e paditësit dhe ka zbuluar mall pa origjinë i cili nuk ka qënë në përputhje me faturën e prezantura nr.10-05 të datës 03.05.2006 dhe DDU-në nr.251361 e cila nuk është përputhur me gjendjen faktike të mallit. Andaj Sektori Antikontrabandë ka vepruar drejtë kur ka konfiskuar mallin dhe kur ka shqiptuar gjobën administrative në vlerë prej 500.00€ në vështrim të nenit 26 paragrafi 1 pika (c) Rregullorja 2005/32 mbi Kodin e Akcizës në Kosovë. Po ashtu Sektori Antikontrabandë ka vepruar drejtë kur e ka konfiskuar automjetin e paditësit në vështrim të nenit 29 paragrafi 1 pika (a) Rregullorja 2005/32 mbi Kodin e Akcizës në Kosovë.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, Gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qënë në gjendje që Gjykatës t'ia dëshmoj me prova konkrete se me aktin administrativ të kontestuar është shkelur ligji në dëm të tij.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar kërkesën e paditësit për kthimin e automjetit të konfiskuar për shkak se i njëjti është futur në lajthitje dhe për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, për arsye se këto pretendime janë të pabaza dhe nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe nga gjendja e konstatuar nga ana e të paditurës. Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur paditësit ia ka konfiskuar automjetin me të cilin ka

transportuar mallra pa akcizë për arsye se në vështrim të nenit 29 paragrafi 1 pika a, Rregullorja 2005/32 mbi Kodin e Akcizës në Kosovë parashihet që “Çdo automjet, kontenjer apo çfarëdo gjëje që është shfrytëzuar për bartjen, trajtimin apo fshehjen e produkteve më akcizë do t’i nënshtrohet ndaljes dhe konfiskimit”. Në rastin konkret paditësi është gjetur duke bartur produkte për të cilat nuk është paguar detyrimi i akcizës se si i tillë i është nënshtruar masës së konfiskimit.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi kontestues i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.C, 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, si dhe nenit 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal

A.nr.1005/18 datë 17.05.2021

Sekretarja Juridike  
Sanie SALIHU

Gj y q t a r i,  
Fisnik NULI

\_\_\_\_\_

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.